



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

# TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

## “Gjerdani i Artë”

**Konkurs për krijimtari muzikore korale “A capella”, për korin e  
Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore, AKVP**

### **I. Përshkrimi i projekti**

Konkursi për krijimtari muzikore “Gjerdani i Artë”, synon mbështetjen e krijimtarisë shqiptare dhe promovimin e krijimtarisë muzikore në vend, si dhe mbështetjen e muzikës sonë tradicionale. Ky konkurs synon gjithashtu krijimin e materialeve të reja muzikore, që bazohen te tradita, dhe sjellin risi.

Nëpërmjet këtij konkursi do të përzgjidhen tre krijimet me të mira, ndërsa 10 nga krijimet më të mira pjesëmarrëse në konkurs do të interpretohen në një koncert premierë nga Kori i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore

1. Çmimi i Parë, “Gjerdani i Artë”
  - Kor dhe orkestër
  - Kor solist dhe orkestër
2. Çmimi i dytë, “70-Vjetori i TKOB ”
  - Kor “a capella” + solist
3. Çmimi i tretë
  - Kor “a capella”

### **II. Objektivat e projektit**

- Të inkurajojë krijimtarinë e re dhe krijimin e veprave muzikore origjinale nga kompozitorët shqiptarë, bazuar te tradita.

- Të promovojë talentin dhe potencialet e kompozitorëve shqiptarë në skenën e Teatrit të Operës dhe Baletit
- Të ndërtojë një platformë të qëndrueshme për mbështetjen dhe zhvillimin e krijimtarisë muzikore në Shqipëri
- Të ndikojë në rritjen e cilësisë artistike në Shqipëri, që të ndërtojë një shoqëri me vlera të forta kulturore.

### **III. Kriteret e pjesëmarrjes**

Konkursi i kompozicionit “Gjerdani i Artë” synon evidentimin dhe mbështetjen e kompozitorëve shqiptarë, që sjellin krijime të reja muzikore, bazuar në motive popullore. Për të marrë pjesë në konkurs, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes si më poshtë vijon:

#### **Kritere të përgjithshme:**

1. Konkursi është i hapur për kompozitorët profesionistë shqiptarë në gjithë hapësirën mbarëkombëtare që kanë përfunduar studimet për kompozicion, pa kufizim moshe.
2. Çdo kompozitor lejohet të paraqesë 2 krijime për kor “a capella”
3. Partiturat duhet të jenë të notizuara me kompjuter dhe të paraqiten në format elektronik.
4. Në dosjen e aplikimit, përveç partiturave të krijimeve paraqitet edhe një CV e kompozitorit si dhe diploma e studimeve për kompozicion.

### **IV. Regjistrimi në Konkurs**

Për tu regjistruar në konkurs kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë së Teatrit të Operës dhe Baletit, në adresën Sheshin Skënderbej.

Deri më datë 18.01.2024, dokumentacionin si më poshtë vijon:

Një zarf i cili duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- Të dërgojë në mënyrë elektronike një video prezantimi, ku prezanton veten dhe punën e tij/ saj
- Formularin e aplikimit të plotësuar (bashkëngjitur);
- Kartën e Identitetit ose pasaportë;
- Portofoli i veprimtarisë së krijuesit (CV);
- Diplomë;
- Dy fotografi të përditësuara;
- Partiturën e veprës të shkruar me një program notëzimi (Finale, Sibelius, Dorico etj);
- Materialin e kompozuar në version audio

Partitura duhet të garantojë anonimatën e kompozitorit dhe titullit, nëse ka, të veprës. Rrjedhimisht, përveç notave muzikore dhe shënimeve të tjera shprehëse të veprës (dinamika,

legjende interpretimi etj) partitura duhet të përmbajë një **Kod** (të shkruar qartësisht në faqen e parë) dhe nuk duhet të ketë asnjë shenjë tjetër (emër kompozitori, titull etj).

- Letër miratimi në rast përzgjedhjeje si vepër fituese, për interpretimin e saj në një koncert me pjesëmarrje masive të kompozitorëve shqiptarë.
- Kandidatët që klasifikohen fitues, menjëherë pasi të njoftohen për rezultatet paraprake duhet të dorëzojnë partet e veprës, (të shkruar me një program notëzimi)

## **V. Kritere Specifike**

1. Krijimet muzikore kërkohen për kor “a capella”, pa shoqërim, për formacion SATB (soprano, alto, tenor dhe bas-bariton).
2. Krijimet muzikore duhet të jenë të mbështetura mbi motive popullore këngësh nga gjithë hapësira mbarëkombëtare.
3. Kohëzgjatja e krijimit të jetë nga 3-5 minuta.
4. Preferohen që krijimet të risjellin materialin muzikor popullor në një stad të ri, qoftë si harmonizim, përpunim, stilizim apo edhe krijim i ri me frymë popullore.

## **VI. Të drejtat e autorit**

Të drejtat e autorit do të zbatohen në përputhje me legjislacion në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to. Në rast se vepra muzikore kualifikohet apo shpallet fituese, TKOBAP, ka të drejtën e përdorimit për vënien në skenë të veprës origjinale dhe të prejardhur që do të ekzekutohet nga trupat artistike të Institucionit/Institucioneve. Ky shfrytëzim nuk bie ndesh me shfrytëzimin normal të veprës së autorit apo mbajtësit të së drejtës. Deklaratë noteriale mbi origjinalitetin e veprës për mos adaptimin nga vepra të tjera, apo plagjiaturë.

## **VII. Juria dhe përbërja e saj:**

Veprat e plota do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga një juri me personalitete të fushës

## **Afatet**

Konkursi qëndron i hapur për një periudhë 1 mujore nga data e shpalljes. Krijimet dërgohen në adresën elektronike të sekretarise së konkursit si më poshtë:

[sekretaria@tkob.gov.al](mailto:sekretaria@tkob.gov.al)